



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1426 / Prot.

Patos, më 11.06 / 2026

PROCESVERBALI I TAKIMIT 10 QERSHOR 2026

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 11:30

Ora e mbarimit: 12:30

Dëgjuesë publike me temë: “Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës së drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik me nr. 250/1 prot, datë 29.04.2026 “Për realizimin e konsultimit publik për Planin Lokal të Cilësisë së Ajrit 2026-2028”.

Pjesëmarrës: Sekretar i Këshillit Bashkiak, znj. Refaela Xeba, Sekretar i Përgjithshëm znj. Juella Shpata, përfaqësues të bashkisë Patos, banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj.

24 pjesëmarrës

Takimin hapet nga sekretar i Këshillit znj. Refaela Xeba- Të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit



**Sekretar i Këshillit
znj. Refaela Xeba**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-2028”
Qershor 2026**

Bashkiak “Për konsultimin publik”, jemi këtu sot për të prezantuar para jush dokumentin përfundimtar lidhur mbi Planin Lokal të Cilësisë së Ajrit 2026-2028. Ftoj ekzekutivin të prezantoj materialin dhe sipas rregullave mund të drejtoni pyetjet tuaja.

Përgjegjëse e sektorit të mjedisit dhe pyjeve, znj. Blerina Laçi- Përshëndetje të gjithëve! Sot po prezantojmë në këtë dëgjese Planin të Cilësisë së Ajrit 2026-2028, i cili vjen si rezultat



**Përgjegjëse e sektorit të mjedisit dhe
pyjeve
znj. Blerina Laçi**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”
Qershor 2026**

i rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe një detyrë që na e ngarkon ligji. Ky plan bazohet në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e ajrit dhe menaxhimin e mbetjeve, përfshirë ligjet e vitit 2024 deri në vitin 2025 dhe VKM përkatëse në përputhje me objektivat e bashkimit evropian. Profili i territorit të bashkisë Patos dhe burimet e ndotjes janë:

Bashkia Patos ka një zhvillim të kombinuar urban dhe industrial ku sektori kryesor është industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit në zonat naftëmbajtëse Patos Marinëz e cila konsiderohet si zona më e nxehtë ekologjike. Burime të tjera të ndotjes përfshijnë trafikun rrugor, automjetet që janë të vjetra dhe përdorin si lëndë djegëse naftën, ngrohjet e banesave dhe proceset e djegies së mbetjeve urbane.

Gjendja e monitorimit të Planit.

Aktualisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka një stacion zyrtar monitorimi për zonën e Patosit. Monitorimet e tanishme nga viti 2023-2025 janë kryer nga vet bashkia me autoritet privat të certifikuar dhe tregojnë se këto nivele janë brenda normave të lejuara, por gjithashtu evidentohet nevoja urgjente për një monitorim të vazhdueshëm 24 orarsh. Ndotësit kryesor që janë identifikuar janë oksidet e azotit, dyoksidi i squfurit, oksidet e karbonit etj. Si sugjerim për uljen e tyre vjen zgjerimi i hapësirave të gjelbra publike, veçanërisht mbjella e pemëve kryesisht në zonat e ndotura. Kjo është pak a shumë përmbledhja e Planit të Cilësisë së Ajrit. Nëse keni pyetje jeni të mirëpritur.

Përfaqësues i shoqatës ambientaliste, z. Qani Rredhi- Përshëndetje! A i keni inspektuar



**Përfaqësues i shoqatës
ambientaliste
z. Qani Rredhi**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit
2026-2028”
Qershor 2026**

ndonjëherë ato rrugët e lagjeve për ndotje të ajrit? A i keni konstatuar nëse kanë qënë të lagura rrugët sepse të mbjellat e fushës jaçenë të mbuluara më re pluhuri nga rrugët. Shqetësimet e banorëve Zharrëz janë në zonat e banuara lidhur me shpërndarjen e plehut me makineri dhe kamion nëpër fshat për përdorim nga fermerët.

Përgjegjëse e sektorit të mjedisit dhe pyjeve, znj. Blerina Laçi- Po ne kemi bërë monitorim të vazhdueshëm dhe nuk kemi konstatuar problematika. Por unë e përmenda dhe më sipër në prezantimin e planit që lind nevoja për monitorim 24 orarsh. Ligji na detyron të monitorojmë parametrat mjedisor dhe ne këtë proces e kemi bërë.



**Përgjegjëse e sektorit të mjedisit dhe
pyjeve
znj. Blerina Laçi**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”**

Administrator i njësisë Zharrëz, z. Riza Hoxha- Lidhur me çështjen e plehut të pulave ne



**Administrator i njësisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”
Qershor 2026**

kemi dijeni që është një banor që bën shpërndarjen e tij në fshat, por nuk kemi marrë asnjë kërkesë me shkrim nga ana e banorëve lidhur me këtë situatë.

Banor i Belinës, z. Feti Gjishti- Përshëndetje! Belina është shumë e rrezikuar nga përmbytjet për shkak të lumit. Nuk e di çfarë është bërë dhe çfarë do bëhet për të shpëtuar Belinën nga rreziku? Ne kemi tokat e përmbytura, por kemi dhe Bankersin. Andej nga pjesa e lumit mbase bie shtrati lumit ngelet uji aty sepse nuk ka kanale dhe nuk ka ku të kulloj. Duhet të behën kanalet.



**Banor i Belinës
z. Feti Gjishti**

**Dëgjesë publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”
Qershor 2026**

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- Ne kemi shqetësim për plehun pasi fermerët i marrin nga pularia dhe i përdorin për serat. Ata duhet ti mbulojnë këto plehëra ose ti hedhin në tokë dhe ta mbulojnë në moment. Për sa i përket Bankersit ne kemi problem pasi nuk ujiten rrugët dhe ullinjtë pas malit bajames janë zbardhur, janë bërë borë e bardhë nga pluhurat. Kam marrë disa ankesa nga banorët.



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha**

**Dëgjësë publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”
Qershor 2026**

Përgjegjëse, znj. Blerina Laçi– Të gjitha këto problematika do ti verifikojmë dhe do të marrim masa lidhur me ndërhyrje për zgjidhjen e tyre.



**Përgjegjëse
znj. Blerina Laçi**

**Dëgjësë publike me temë:
“Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2026-
2028”
Qershor 2026**

Sekretar i Këshillit znj. Refaela Xeba- Nëse nuk ka komente të tjera e deklaroj të mbyllur këtë dëgjësë publike.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba